

Në bazë të nenit 37 të Rregullores për shpalljen e Zgjedhjeve për Kryetar të Parlamentit Studentor të Universitetit të Tetovës dhe njësisë të Universitetit të Tetovës dhe nenit 3 të Vendimit për shpalljen e Zgjedhjeve për zgjedhjen e Kryetarit të Parlamentit Studentor të Universitetit të Tetovës, Komisioni Zgjedhor i Parlamentit Studentor të Universitetit të Tetovës, më 19.12.2016 solli këtë:

VENDIM

për vërtetimin e kandidaturave të kandidatëve për zgjedhjen e Kryetarit të Parlamentit Studentor të Universitetit të Tetovës, Kryetarëve të Parlamenteve Studentore të fakulteteve dhe anëtarëve të Parlamenteve Studentore të fakulteteve të Universitetit të Tetovës

Neni 1

Vërtetohen kandidaturat e kandidatëve për zgjedhjen e Kryetarit të Parlamentit Studentor të Universitetit të Tetovës (të radhitur sipas radhës alfabetike):

1. **Argëtim Arifi**, student i Fakultetit të Administratë Biznesit dhe
2. **Donika Kamberi**, studente e Fakultetit Juridik.

Neni 2

Vërtetohen listat e kandidaturave të kandidatëve për zgjedhjen e Kryetarëve të Parlamenteve Studentore të fakulteteve, të propozuar nga kandidatët për zgjedhjen e Kryetarit të Parlamentit Studentor të Universitetit të Tetovës.

Listat nga paragrafi i kaluar janë pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Neni 3

Vërtetohen listat e kandidaturave të kandidatëve për zgjedhjen e anëtarëve të Parlamentit Studentor të fakulteteve në Universitetin e Tetovës, të propozuar nga kandidatët për zgjedhjen e Kryetarit të Parlamentit Studentor të Universitetit.

Listat nga paragrafi i kaluar janë pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Neni 4

Listat e kandidaturave të kandidatëve për Kryetarin e Parlamentit Studentor të Universitetit të Tetovës, Kryetarët e Parlamenteve Studentore të fakulteteve dhe anëtarët e Parlamenteve Studentore të fakulteteve të Universitetit të Tetovës shpallen në tabelën e shpalljeve dhe në faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e sjelljes së tij.

Tetovë, më 19.12.2016

Kryetari i komisionit zgjedhor
në Universitetin e Tetovës
Ermir Arifi

